



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:125482
Datë: 22.04.2024
Numri i dokumentit: 05598641

PA1.nr.1110/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Abdullah Ahmeti - kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Mehmet Ndrecaj - anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen penale ndaj të akuzuarit M. H. , nga P, për shkak të veprës penale Vjedhje , nga neni 313 par 1, të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit M. H. - av. M. B. , të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.2192/23, datë 07.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPP-ës , më datë 21.12.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit M. H. - av. M. B. , ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.2192/23, datë 07.06.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktgjykimin P.nr.2192/23, datë 07.06.2023, të akuzuarin M. H. e ka shpallur fajtor, për shkak të veprës penale Vjedhje , nga neni 313 par 1, të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi dhe dënim me gjobë në shumë prej treqind (300) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur dënimi me gjobë zëvendësohet me dënimin me burgim, njëzet (20) Euro gjobë

llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim. Është obliguar i akuzuari që të paguaj ne emër të shpenzimeve të procedurës penale paushallin gjyqësor ne shumë prej tridhjetë (30) euro, kurse në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur :

Mbrojtësja e të akuzuarit M. H. - av. M. B. , për shkak të vendimit për sanksionin penal, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, aktgjykimin e ankimuar të e ndryshoj dhe të akuzuarit të i shqiptoj dënim më të butë – dënim me kusht.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën PPA/II.nr.1193/2023, të datës 08.09.2023, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit M. H. - av. M. B. , ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit caktoj dhe mbajti seancën e kolegjit, konform dispozitës së nenit 390 të KPP-së e për të cilën seancë i ftoi në mënyrë të rregullt Prokurorin e Apelit, të akuzuarin M. H. , mbrojtësen e tij avokate M. B. dhe të dëmtuarin A. S. . Në seancë prezanto i mbrojtësja e të akuzuarit avokate M. B. , ndërsa Prokurori i Apelit, i akuzuari dhe i dëmtuari edhe pse të ftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt nuk prezantuan në seancë. Gjyqtari referues e referoj çështjen penale. Mbrojtësja e të akuzuarit, deklaroi se mbetem në tërësi pranë ankesës së ushtruar me shkrim, me propozim që e njëjta të aprovohet e njëjta dhe shton se i mbrojturi im e ka marrë si obligim që t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar të dëmtuarit dhe propozon që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti kushtëzohet dënimi.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoj se :

- Ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1 të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe në këto drejtime dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, të cilat do e kishin e kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose

marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen faktike, andaj aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Mbrojtësja e të akuzuarit e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendimit për sanksionin penal duke pretenduar që dënimi i shqiptuar është tejet i rëndë dhe se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk i ka vlerësuar drejtë rrethanat lehtësuese të njëjtat i ka nënvlerësuar, po ta vlerësonte drejt rrethanën posaçërisht lehtësuese pranimin e fajësisë në kuptim të nenit 69 të KPRK të mbrojturit tim do ti shqiptonte dënim më të lehtë, po ashtu konsideroi se gjykat e Apelit duhet të ketë parasysh dhe faktin se i njëjti është mbajtës i familjes dhe gjendjen e rëndë ekonomike si dhe obligimin nga marrëveshja që t'ia kompensoi dëmin e shkaktuar të dëmtuarit dhe se po të mbetet ky dënim atëherë kjo do ta vështirësonte tej mase këtë. I propozon Gjykatës së Apelit të Kosovës, aktgjykimin e ankimuar të e ndryshoj dhe të akuzuarit të i shqiptoj dënim më të ultë- dënim të kushtëzuar.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit, për shqiptimin e dënimit më të ultë-dënimin të kushtëzuar, ndaj të akuzuarit, janë të pabazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila do ta arsyetonte për shqiptimin e dënimit më të ultë, ndaj të akuzuarit. Kështu, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit e duke u bazuar konform të dispozitës së nenit 69 dhe 70 të KPRK, për të akuzuarin mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rrethanat rënduese si dhe udhëzuesin për politikën ndëshkimore të aprovuar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës. Si rrethanë lehtësuese Gjykata vlerësoi pranimit e fajësisë nga i akuzuari, i njëjti ka pranuar fajësinë në tërësi për veprën penale për të cilën akuzohet në seancën e shqyrtimit fillestar, shprehja e ndjenjës së keqardhjes për veprën penale të cilën e ka kryer, i kërkon falje palës së dëmtuar, zotohet para gjykatës se do të kompensoi dëmin e shkaktuar ndaj palës së dëmtuar në vlerë monetare, i premton gjykatës se nuk do të përsërisë më vepra penale në të ardhmen. Ndërsa ndaj të akuzuarit si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, dashjes e plotë të kryerësit për kryerjen e veprës penale, fakti se i akuzuari bazuar në dokumentin “informacionet e personit” të siguruar nga policia e Kosovës dyshohet për një numër të madh të veprave të njëjta penale (vjedhja), fakt ky i cili tregon për karakteristikat personale të kryerësit të veprës penale. Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura gjykata e shkallës së parë i shqiptoi të akuzuarit dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar me bindjen se edhe me një dënim të tillë do arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara lehtësuese në ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të atij karakteri dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë apo që akuzuarit të i shqiptoj dënim më të ultë- dënim me kusht, sikurse që

pretendohet në ankesë, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutorë dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me këtë kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tij. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 401 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.1110/23, më datë 21.12.2023

Zyrtarja ligjore;
Rrezarta Bala

Kryetari i kolegjit
Abdullah Ahmeti

Anëtarët e kolegjit:
Ferit Osmani

Mehmet Ndrecaj